



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2615, datë 10.09.2015

Për

**“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a. në lidhje me dokumentin
“Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të
komunikimeve elektronike”, miratuar me VKD Nr.2583, datë 10.07.2015”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|-----------------|----------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj.Anila | Denaj | Anëtar |
| 4. Znj. Klarina | Allushi | Anëtar |
| 5. Znj.Ketrin | Topçiu | Anëtar |

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.09.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a. në lidhje me dokumentin
“Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të
komunikimeve elektronike” miratuar me VKD Nr.2583, datë 10.07.2015**

BAZA LIGJORE:

- 1) Neni 7, neni 8 gërma p), neni 22 i Ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 9918*).
- 2) Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.

- 3) “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike”, miratuar me VKD Nr.2583, datë 10.07.2015.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit (*Relacioni*),
2. Ankimi administrativ i sipërmarrësit Albtelecom sh.a për Modifikimin e Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2583, datë 10.07.2015 Per "Miratimin e dokumentit " Rregulla per perdorimin e perbashket te faciliteteve dhe aseteve te rrjeteve te komunikimeve elektronike”, dërguar me shkresën Nr.6718 Prot., datë 10.08.2015.
3. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP me Vendimin Nr.2583, datë 10.07.2015, miratoi dokumentin "Rregulla per përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike”. Miratimi i dokumentit u krye pas procesit të këshillimit public, gjatë së cilës AKEP morri në konsideratë komentet e dërguara nga palët e interesuara.
2. Albtelecom me shkresën Nr.6718 Prot., datë 10.08.2015 (Ref. e AKEP Nr.1529 prot., datë 11.08.2015) ka dërguar ankim administrativ duke kërkuar modifikimin e disa pikave të dokumentit "Rregulla per përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike”, të miratuar me VKD Nr.2583, datë 10.07.2015.
3. Kërkesat e Albtelecom për modifikimin e disa pikave të rregullores janë si më poshtë:

1. Ne lidhje me nenin 5, pika 8, neni 6, pika 10, neni 7, pika 10:

Perfshirjen ne rregulloren e re te komentit të Albtelecom (gjatë këshillimit publik) lidhur me nenin 5 pika 8, ku kerkohet modifikimi si vijon: *"Në rast se operatori i infrastruktures nuk kthen pergjigje brenda 45 diteve nga marrja e kerkeses se operatorit perfitues, operatori kerkon fillimin e procedurave ne AKEP per te kerkuar zgjidhjen sipas parashikimeve ne Proceduren per Zgjidhjen e Mosmarreshjeve"*

2. Ne lidhje me nenin 5, pika 4/e;

Pasqyrimin ne piken 4/e te nenit 5 te Rregullores se re te komentit te Albtelecom (gjatë këshillimit publik) lidhur me tubin qe perdoret ne pusetat e

infrastruktues ku eshte kerkuar qe do te ishte i mjaftueshem vetem informacioni per "Llojin e tubave midis dy pusetave".

3. Në lidhje me nenin 6, pika 3

Saktesimin ne rregulloren se re te ndryshimit lidhur me afatin brenda te cilit duhet te kthehet pergjigja per operatorin e interesuar, nga 15 dite ne 30 dite.

4. Në lidhje me nenin 8, pika 7/d:

Kjo pikë të riformulohet me këtë tekst: *“Orientimin ne kosto te tarifave per perdorimin e perbashket nga ofruesi i infrastruktures, duke marre parasysh kostot bistorike”*.

4. AKEP pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën dhe argumentet e Albtelecom vlerëson si më poshtë:

1. Në lidhje me komentin në pikën 3.1 më sipër, afati nuk duhet të ndryshohet nga 30 në 45 ditë, pasi afati 30 ditor është përcaktuar në rregullore për kthim përgjigje nga operatori i infrastrukturës për operatorin përfitues për mundësinë ose pamundësinë e dhënies së aksesit. AKEP pranon të ndryshojë përcaktimet e nenit 5, pika 8, nenit 6 pika 10 dhe nenit 7, pika 10 me tekstin e mëposhtëm:

Në rast se operatori i infrastrukturës nuk kthen përgjigje brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së operatorit përfitues, ky i fundit ka të drejtë të kërkojë fillimin e procedurave në AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas nenit 22 të Ligjit 9918

2. AKEP pranon komentin në pikën 3.2 më sipër, duke sqaruar se mos-reflektimi në rregullore është një lapsus, pasi në qëndrimin ndaj komenteve është pranuar kërkesa e Albtelecom.

3. AKEP pranon kërkesën në pikën 3.3 më sipër për ndryshimin në nenin 6, pika 3, pasi është ne përputhje me nenet e tjera të rregullores së miratuar.

4. Kërkesa në pikën 3.4 nuk pranohet dhe arsyet janë dhënë tashmë në qëndrimin ndaj komenteve në këshillimin publik.

5. Për sa më sipër, AKEP gjykon të kryejë dy saktësime në rregulloren e miratuar me VKD Nr.2583, date 10.07.2015.

PËR KËTO ARSYE:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në nenin 110, 114, dhe në nenin 115 të ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 i ndryshuar, dhe Kodin e Procedurave Administrative, Këshilli Drejtues i AKEP:

V E N D O S:

1. Të pranojë pjesërisht ankimin administrativ të Albtelecom për modifikimin e disa pikave të dokumentit "*Rregulla per përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike*", të miratuar me VKD Nr.2583, date 10.07.2015, duke bërë ndryshimet e mëposhtëme në dokumentin e cituar:
 1. Teksti në nenin 5, pika 8, nenin 6, pika 10 dhe nenin 7 pika 10 ndryshohet si më poshtë:
Në rast se operatori i infrastrukturës nuk kthen përgjigje brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së operatorit përfitues, ky i fundit ka të drejtë të kërkojë fillimin e procedurave në AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas nenit 22 të Ligjit 9918
 2. Teksti në nenin 5, pika 4/e zëvendësohet me: **Llojin e tubave midis dy pusetave.**
 3. Në nenin 6, pika 3, afati **15 ditë** zëvendësohet me **30 ditë**.
2. Ky Vendim dhe ndryshimet e miratuara në dokumentin e cituar në pikën 1 të këtij Vendimi, të publikohen në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R
Piro XHIXHO

ANËTARË:

Z.Alban KARAPICI

Znj.Anila DENAJ

Znj.Klarina ALLUSHI

Znj.Ketrin TOPCIU